REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.5734 Prot.

Maliq, më 28.09.2026

VENDIM
Nr.113, datë 28.09.2026

PËR

"SHPREHJEN E MOSDAKORTËSISË TË KËSHILLIT BASHKIAK MALIQ ME PROPOZIMIN PËR BASHKIMIN E BASHKISË MALIQ ME BASHKINË KORÇË NË KUADËR TË RIORGANIZIMIT ADMINISTRATIVO-TERRITORIAL"

Mbështetur në:

• nenin 108, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit kufijtë e njësive të vetëqeverisjes vendore nuk mund të ndryshohen pa u marrë më parë mendimi i popullsisë që banon në to;

• nenin 86 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", për riorganizimin administrativo-territorial me ose pa ndryshim të kufijve, në funksion të interesave ekonomikë e socialë dhe realizimit në nivel më të lartë të funksioneve në përfitim të bashkësisë vendore;

• nenin 87, shkronja "b", të ligjit nr. 139/2015, sipas të cilit riorganizimi me ndryshim kufijsh bëhet kur dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore shkrihen për të formuar së bashku, në territorin e tyre, një njësi të vetme të vetëqeverisjes vendore;

• nenin 89 të ligjit nr. 139/2015, lidhur me mbështetjen ligjore dhe dokumentacionin që duhet t'i bashkëlidhet propozimit për riorganizim, përfshirë arsyet ekonomike, sociale, kulturore, demografike e administrative, mendimin e popullatës, hartat administrativo-territoriale dhe mënyrën e rregullimit të çështjeve financiare e të detyrimeve;

• nenin 90, pikat 1 dhe 3, të ligjit nr. 139/2015, sipas të cilit këshillat bashkiakë të përfshirë drejtpërdrejt në riorganizim japin mendimin e tyre zyrtar dhe ky mendim jepet brenda 60 ditëve nga data e marrjes së kërkesës së propozuesit;

• Rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak Maliq, miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.24, datë 12.03.2020;

• Përgjegjësinë e Këshillit Bashkiak Maliq për të përfaqësuar interesat e komunitetit vendor dhe për t'u shprehur institucionalisht mbi ndryshimet që prekin territorin, organizimin administrativ, financat, pasuritë, detyrimet dhe vazhdimësinë e shërbimeve publike; me propozim të Këshilltarve sipas listës (bashkangjitur).Këshilli bashkiak Maliq,

VENDOSI:

1. Të shprehë mosdakortësinë e Këshillit Bashkiak Maliq lidhur me propozimin për bashkimin e Bashkisë Maliq me Bashkinë Korçë, në kuadër të riorganizimit administrativo-territorial të propozuar.

2. Të shprehë mosdakortësinë që, me hyrjen në fuqi të ligjit përkatës të riorganizimit administrativo-territorial, territori aktual i Bashkisë Maliq të përfshihet në territorin e

Bashkisë Korçë dhe Bashkia Korçë të vijojë si njësia e vetëqeverisjes vendore që administron territorin e riorganizuar, sipas përcaktimeve të ligjit të miratuar.

3. Të konstatojë se mendimi i popullsisë së njësive të prekura nga riorganizimi, përfshirë popullsinë e territorit aktual të Bashkisë Maliq duhet të jetë i dokumentuar dhe t'i bashkëlidhet propozimit për riorganizim, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin nr. 139/2015.

4. Të kërkojë që në dosjen parlamentare dhe në dokumentacionin përfundimtar të procesit të përfshihet i plotë ky vendim si mendimi zyrtar i Këshillit Bashkiak Maliq, së bashku me çdo mendim "kundër" të një pjese të këshilltarëve, nëse ka, sipas nenit 90 të ligjit nr. 139/2015.

5. Kryetari i Këshillit Bashkiak Maliq autorizohet t'ia përcjellë këtë vendim Kuvendit të Shqipërisë, komisionit parlamentar përgjegjës, propozuesit të projektligjit, Këshillit të Ministrave, Prefektit të Qarkut Korçë dhe institucioneve të tjera të interesuara.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit.

Miratuar me 21 vota
Vota Pro 21
Vota Kundër 1
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 28.09.2026

KRYETARI I KËSHILLIT
Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ